



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 667/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rrustem Thaçi kryesues, Ferki Xhaferi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik G.I Zubin Potok paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të keqpërdorimit të fletëvotimeve, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të datës 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 20.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.667/2021 e datës 18.10.2021, e paraqitur nga G.I Zubin Potok, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të keqpërdorimeve të fletëvotimeve, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të datës 17 tetor 2021.

A r s y e t i m

Me datë 18.10.2021, PZAP, ka pranuar ankesën Anr.667/2021 të paraqitur nga G.I Zubin Potok, me të cilën pretendon se në vendvotimin 2815-01 një anëtar i komisionit të vendvotimit rreth orës 17 votoi në emër të votuesve që mungonin. Përfaqësuesi i GIZP ndërhyri dhe i raportoi parregullsitë përfaqësuesit të KKZ-së, pasi e bindi përfaqësuesin e GIZP -së që të mos shkruajë ankesë dhe mos pranimi i përfaqësuesit të GIZP -së, anëtari i KKZ -së kërcënoi se anëtari ynë do të jap përgjegjësi nëse nuk e tërhiqte ankesën. Për këtë u njoftua edhe Policia.

Gjatë procesit zgjedhor, përfaqësuesi ynë u nxor disa herë nga qendra e votimit dhe u intervistua, që do të thotë se ai mungoi për më shumë se një orë. Në të njëjtin vend, disa persona votuan në emër të dikujt tjetër me miratimin e kryetarit të këshillit të vendvotimit.

PZAP-i me datë 19.10.2021 i ka dërguar KQZ-së kërkesë për përgjigje lidhur me ankesën dhe Policisë së Kosovës – Zubin Potok kërkesë për raport lidhur me mbarëvajtjen e procesit zgjedhor në vendvotimin 2815B/01D.

Në përgjigje në ankesë të datës 19.10.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), duke vepruar sipas kërkesës së PZAP-it ka dërguar në kopje fizike Formularin e Përputhjes së të dhënave dhe Rezultateve për Kryetar Komune, Formularin i Përputhjes së të dhënave dhe Rezultateve për Kuvend Komunal, Librin e Votimit dhe Listën e Votuesve.

Gjithashtu sipas kërkesës së PZAP-it, Policia e Kosovës me datë 19.10.2021 ka dërguar raportin policor lidhur me mbarëvajtjen e procesit zgjedhor në vendvotimin 2815-01.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP, pas shqyrtimit të ankesës, provave të bashkangjitura në ankesë, përgjigjes në ankesë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) dhe Raportit të Policisë së Kosovës, për shkak të keqpërdorimeve të fletëvotimeve, konstatoi se ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shqyrtimit të Librit të Votimit në pjesën e Shënimeve mbi procedurat e votimit dhe numërimit gjatë ditës së zgjedhjeve ku thuhet se gjatë votimit, anëtarja e KVV-së Slavica Milovanovic ka bërë akuza se KVV-ja po bën malverzime me fletëvotimet. Për më shumë e njëjta ka qenë në korridor jashtë VV-së, dhe për një moment hyri brenda në VV dhe filloi me akuzat se po bëhen malverzime me materialet zgjedhore, pa pasur asnjë dëshmi apo provë. Gjatë tërë kohës së procesit zgjedhor fliste me telefon dhe merrte instruksione për të sabotuar zgjedhjet, duke dashur që me çdo kusht të prishë procesin zgjedhor, i cili vazhdonte mirë dhe sipas gjitha rregullave, dhe pa asnjë ankesë.

Nga krejt kjo zhurmë, dhe nga akuzat e pabazuara, ajo doli më një shantazh dhe me një propozim që të i lejohej që, pa asnjë kontroll dhe kundër të gjitha rregullave dhe ligjeve të i fut në kutinë e votimit gjysmën e paketimit e fletëvotimeve për kandidatin e saj Biševac. Të gjithë anëtarët e kanë refuzuar dukë iu shpjeguar qartë se kjo ishte kundërligjshme. Duke e parë se anëtarët e KVV-së nuk pajtoheshin me propozimin e saj, ajo ka denoncuar rastin në organet kompetente, me ndihmën e njerëzve me të cilët kontaktonte gjatë gjithë kohës përmes telefonit.

Në ora 18:30 ka ardhur Prokurorja e Shtetit e cila ka marrë deklaratat nga anëtarët e KVV-së.

Bazuar në këtë provë, paneli nuk mundi të vërtetojë se ka pasur shkelje ashtu siç pretendohet në ankesë pasi që nga Libri i Votimit, pjesës së Shënimeve mbi procedurat e votimit dhe numërimit gjatë ditës së zgjedhjeve u vërtetua se nuk ka pasur parregullsi dhe se këto pretendime kryesuesi i këshillit të vendvotimeve dhe anëtarët e saj i cilësojnë si të pavërteta andaj të njëjtave paneli ua fali besimin.

Gjithashtu nga raporti i Policisë së Kosovës i datës 19.10.2021 vërtetohet se me datën 17 tetor 2021, rreth orës 18:10, Stacioni Policor në Zubin Potok ka pranuar një raportim nga ankuesi Slavica Milovanovic për disa parregullsi në vendvotimin 2815-b për fshatin Ugljare, të vendosur në shkollën fillore "Jovan Cvijic në Zubin Potok. Polica e Kosovës pas pranimit të raportimit ka dalur në vendin e ngjarjes ku dhe ka intervistuar ankuesen e cila ka pretenduar se gjatë procesit zgjedhor një anëtarë i komisionit zgjedhor Svetlana Vucinic mori 3-4 fletëvotime, i firmosi, i grisi dhe i fshehu ato nën procesverbal. Lidhur me këtë Policia ka intervistuar Kryetaren e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve, Dusica Spasojevic, e cila theksoi se në vendvotimin kishte pranuar 250 se 197 qytetarë kryen detyrën e tyre qytetare (votimin) dhe se mbetën 53 fletëvotime të papërdorura, që arrin një total prej 250 fletëvotimeve të pranuar.

Bazuar në informacionin e mbledhur të njëjtën ditë në orën 19.10 nga Prokuroja e Shteti, Stojanka Kasalovic, u mbajt një konsultim me Shefin e Prokurorisë Themelore për Mitrovicën, Ismet Ujkani, i cili pasi u njoh me të gjitha detajet urdhëroi një çështje penale kundër Slavica Milovanovic, "Raportim ose thirrje e rreme" nga neni 382 i KPK-së.

Paneli duke u bazuar në Librin e Votimit në pjesën e Shënimeve mbi procedurat e votimit dhe numërimit gjatë ditës së zgjedhjeve si dhe Raportin e Policisë së Kosovës lidhur me ankesën e subjektit politik G.I. Zubin Potok, vlerëson se e njëjtat është e pabazuar ngase këto pretendime për shkelje nuk janë evidentuar nga Kryesuesi i Këshillit të Vendvotimit apo anëtarët e saj e po ashtu as nga Raporti i Policisë së Kosovës nuk evidentohen shkelje, për më tepër për këto pretendime ndaj ankueses Svetlana Vucinic është ngritur edhe iniciuar rast penal pranë Prokurorisë Themelore në Mitrovicë nën dyshimin për raportim apo thirrje të rreme.

Andaj, Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga Gordanska Iniciativa Zubin Potok, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje e në procesin e votimit me datën 17.10.2021, në Vendvotimit 2815B/01D.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.667/2021 më datën 20.10.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas neni 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.